



Republika e Kosovës/ Republika Kosova
Republic of Kosovo
Komuna Istog/ Opštine Istok/ Municipality of Istog



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi / Direkcija za Poljoprivredu, Sumarstvo i
Vodoprivredu / Departament of Agriculture, Forestry and Hydro-economy

Datë: 19.05.2023

**Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisionit vlerësues
për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve**

Bazuar në Thirrjen e datës **16.05.2023** të publikuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë/ Komuna e Istogut për mbështetje financiare për projekte/ programe të OJQ-ve, me qëllim të *"Mbështetjes financiare për projektet e OJQ-ve për organizimin e aktivitetit tradicional, qethja e deleve, "Te qethat 2023"*, ftojmë përfaqësuesit e organizatave jo qeveritare/shoqërisë civile dhe ekspertët, të aplikojnë për të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit, në cilësinë e ekspertëve të jashtëm.

Rregullorja MF-nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të organizatave joqeveritare, në nenin 8 paragrafi 3.2, përcakton që pjesë e secilit komision vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar në thirrjet publike duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, përfshirë përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.

Për këtë qëllim, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë fton të gjithë kandidatët e interesuar të aplikojnë për të qenë pjesë e komisionit vlerësues si ekspertë të jashtëm për të vlerësuar projekt propozimet e paraqitura nga OJQ-të përmes thirrjes publike.

- Një përfaqësues nga OJQ-të

- Një përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit

Të drejtën për të aplikuar kanë:

- Punonjësit në organizata joqeveritare që veprojnë në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur me të paktën 2 vjet përvojë pune në hartimin dhe menaxhimin e projekteve, ose fusha të ngjashme.

Aplikantët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Duhet të kenë të paktën nivelin e studimeve themelore universitare - Bachelor;
- Dëshmi të përvojës së punës;
- Përvojë në projekte të OJQ-ve;
- Nuk duhet të jenë të emëruar politik, nëpunës civilë ose në pozita të ngjashme në administratën publike.

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Letër motivimi;
- CV e azhurnuar;
- Provat e arsimimit dhe të përvojës së punës;
- Punonjësit e OJQ-ve duhet të paraqesin një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën është i punësuar aplikanti.

Tërë dokumentacioni i nevojshëm duhet të dërgohet vetëm përmes adresës elektronike (e-mail; fadil.kabashi@rks.gov.net / Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomis inkurajon fuqimisht anëtarët e komuniteteve jo-shumicë që të aplikojnë në këtë thirrje.

Për informacion shtesë mund të njoftoheni me telefon: 038 200 43 893

Vetëm kandidatët nga lista e shkurtër do të kontaktohen.

Afati i aplikimit është i hapur 5 ditë pune nga data e publikimit, nga 19.05.2023 deri në 25.05.2023.

Aplikacionet që vijnë pas afatit dhe aplikacionet jo të plota do të refuzohen.